

**RAPORTI PERFUNDIMTAR I**  
**GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**PËR PROGRAMIN E STUDIMIT**

**MASTER I SHKENCAVE NË GJUHË DHE**  
**LETËRSI TURKE**

**TË SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “HËNA E**  
**PLOTË” (BEDËR)**

Ekspertë: **1. Prof. Dr. Ferit Duka**  
**2. Dr. Alban Foçi**

**Prill 2013**

## **RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

### **Për Programin e studimit MSc në Gjuhë dhe Letërsi Turke në Shkollën e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër)**

#### **HYRJE**

Masteri I Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Turke në shkollën e lartë “Hëna e plotë” (Bedër) është hapur në vendimin nr.330, date 07.08.2012 të Ministrit të Arsimit të mbështetur në vendimin nr. 351, datë 13.7.2011 të Këshillit të Akreditimit i cili është bazuar në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 44/1 nr 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” të ndryshura.

#### **GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

Përbërja e GVJ:

1. Prof. Dr. Ferit Duka
2. Dr. Alban Foçi

#### **1. Misioni/Objektivat e programit të studimit**

Shkolla e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) me anë të këtij programi synon të përgatisë studentët me dituritë themelore si nga ana e teorive gjuhësore ashtu edhe në ato metodologjike si dhe t'i aftësojë ata për zbatimin e teorisë në praktikë. Zgjidhja e planit mësimor dhe e lëndëve individuale e reflektojnë drejtpërsëdrejti natyrën e mësimin dhe përvetësimit të një gjuhe të dytë në përputhje me nevojat dhe realitetin rajonal. Duke qenë se programi është hartuar edhe për studentë që nuk e kanë gjuhën turke gjuhë amtare, janë vendosur lëndë duke u fokusuar në leximin dhe shkrimin akademik në turqisht. Ekzistojnë komponentë për hulumtime akademike.

Misioni i programit Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Turke është konceptuar në harmoni të plotë me misionin e përgjithshëm të shkollës së lartë “Hëna e Plotë” (Bedër), me standartet ndërkombëtare si dhe me veçoritë dhe risitë që synon ky institucion të sjell në Shqipëri por edhe më gjërë.

Me qëllim arritjen e këtyre synimeve departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Turke gjatë vitit akademik 2011-2012 ka organizuar disa aktivitete në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe kontributit për shoqërinë. Departamenti ka organizuar Konferencën e Parë Ndërkombëtare të Gjuhës dhe Letërsisë “Aspektet e përbashkëta në Kulturën Turke dhe Shqiptare” ku referuan 29 studiues nga katër vende të ndryshme të botës.

Duke paraqitur programe të kompletuara për gjithë njohuritë e nevojshme për përgatitjen e plotë dhe profesionale në gjuhën dhe letërsinë turke, departamenti synon të edukojë, të zgjerojë njohuritë rreth fushës sipas etikës profesionale, për të përgatitur me dituritë themelore si nga teoria gjuhësore ashtu edhe nga ana metodologjike me synimin zbatimin e teorisë në praktikë. Zgjedhja e planit mësimor dhe lëndëve individuale reflektojnë drejt për së drejti natyrën e

mësimin dhe përvetësimin e një gjuhe të dytë në përputhje me nevojat e studentëve.

### **Vlerësimi sipas Standardeve**

<b>Standardi/Kriteret</b>		<b>Vlerësimi i IAL sipas standardit/ kriterit<sup>1</sup></b>
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>		
<b>Kriteri 3</b>	Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës u pa se programet janë hartuar duke pasur parasysh që të përputhen me misionin dhe qëllimin e institucionit.
<b>Kriteri 4</b>	Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	Ndonëse nuk ka një studim të hollësishëm dhe të besueshëm për nevojat e tregut të punës, programet janë përgatitur duke u mbështetur në perceptimin e përgjithshëm mbi mundësitë e punësimit dhe një studim të bërë nga vetë institucioni në fjalë.
<b>Kriteri 5</b>	Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	Programet janë hartuar duke u marr parasysh zhvillimi ekonomik i vendit si dhe mundësitë e punësimit të studentëve pas diplomimit.
<b>Kriteri 6</b>	Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	Programi i ofruar synon të jetë në përputhje me politikën dhe planin strategjik mbi arsimin e lartë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;	Pas vlerësimit të dokumentave vihet re se Departamenti i gjuhës turke, duke qenë pjesë e këtij institucioni, e ka ndërtuar këtë program në harmoni të plotë me strategjinë për zhvillim të tij.
<b>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;	Përmbatja e programeve është në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuar nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
<b>Kriteri 2</b>	Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.	Emërtimi i programit është në përputhje me nivelin e përcaktuar nga Kornizat Shqiptare e Kualifikimit.
<b>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</b>		

<sup>1</sup> GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha kriteret. Në fund të kriterëve duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

<b>Kriteri 1</b>	Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;	Siç shihet edhe në Planin Strategjik të Institucionit, ai është në proces të vazhdueshëm për të përmisuar dhe përshtatur programet e studimeve në bazë të një plani strategjik.
<b>Kriteri 2</b>	Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	Institucioni ka një plan strategjik të mirë për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b> Programi në tërësinë e tij i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara për akreditim. Është një pengesë mungesa e një studimi të thelluar për nevojat e tregut të punës mbi të cilën të zhvillohet një strategji më e mire e cila duket se është plotësuar në një masë të madhe nga studimi i kryer prej vetë institucionit. Duhet të tregohet më shumë kujdes në emërtimin e lëndëve që të përshtaten me brendinë e lëndës.		

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

### Fakulteti i Pjesa përshkrimore

Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit është një nga dy fakultetet që përbëjnë Shkollën e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër). Në përbërjen e tij është edhe Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Turke në të cilën kryehet programi në fjalë. Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Turke përbëhet nga 7 lektor efektiv (PAE) dhe 6 lektor me kontratë (PAK). Departamenti drejtohet nga Përgjegjësi i Departamentit Dr. Adem Balaban dhe ka në përbërje të tij edhe Këshillin e Departamentit dhe Grupin e Vlerësimit të Brendshëm **Tregues të matshëm:**

- Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit
- Organet e zgjedhura në të gjitha nivelet
- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

## 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Programi i masterit të shkencave Gjuhë dhe Letërsi Turke zhvillohet nga Departamenti i gjuhës turke që është pjesë përbërëse e Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit.

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Tabela 1

<b>Fakulteti Filologjisë dhe Edukimit Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Turke</b>							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Adem Balaban	Përgjegjës Dep.	Dr.	1	Genciana Abazi Egro	Prof. As. Dr.	Instituti i Albanologjisë
2	Ceyhun Vedat Uygur	Lektor	Prof.Dr.	2	Dritan Egro	Prof. As. Dr.	Instituti i Albanologjisë

3	Sezai Coskun	Lektor	Prof.As.Dr.	3	Adriatik Derjaj	Dr.	Universiteti i Tiranës
4	Bunyamin Caglayan	Lektor	Dr.	4	Spartak Kadiu	Dr.	Universiteti i Tiranës
5	Gulay Yurt	Lektor	Ma	5	Ermal Nurja	Ma	
6	Hakan Kacar	Lektor	Ma	6	Omer Yurekten	Ma	
7	Huseyin Yilmaz	Lektor			Salih Okumus	Dr	

Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit

Tabela 3

Emër Mbiemër	Titulli/grada	Pozicioni në Këshillin shkencor
Adem Ballaban	Kordinator / Dr.	

Tabela 4

Titulli	Dep 1		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë	1		1/0
Profesorë të As.	1	2	1/2
Doktorë	2	2	2/2
Docentë			
Pedagogë (pa tituj)	3	2	3/2
Asistentë me Ma			
Asistentë pa Ma			
Personeli Administrativ	1		1/0

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
<b>Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;	Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen në përputhje me objektivat e programit të studimit për arritjen e tij.
<b>Kriteri 2</b>	Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	Personeli ndihmës angazhohet në përputhje me strategjinë e institucionit.
<b>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;	Personeli akademik është pjesë e hartimit të kurrikulës, si dhe përmirësimit të programeve
<b>Kriteri 2</b>	Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.	Personeli rekrutohet sipas një procedure transparente me konkurim të hapur me dosje.. Ngarkesa mësimore bëhet në përputhje me marrveshjet e

		punës si dhe duke marr parasysh ngarkesën mësimore dhe detyrat akademike dhe administrative të personelit.
<b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;	Nga takimet me stafin drejtues dhe zyrën e burimeve njerëzore dallohet se Procesi i rekrutimit të personelit bëhet i bazuar në specifikat e departamentit duke u shpallur vendet vakante në faqen zyrtare të institucionit si dhe në median e shtypur. Vlerësimi i dosjeve të kandidatëve bëhet nga një komision i krijuar për këtë qëllim i cili ndjek procedura shumë rigoroze.
<b>Kriteri 2</b>	Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;	Nga vlerësimi i dokumentacionit kuptohet se ky kriter plotësohet në shumicën e rasteve. Ndonëse është institucion i ri, ai përpiqet të plotësojë këtë kriter duke shtuar numrin e stafit akademik me kohë të plotë sipas nevojave të departamentit.
<b>Kriteri 3</b>	Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;	Nga vëzhgimet e bëra gjatë takimeve u pa se personeli vlerësohet në mënyrë transparente dhe të vazhdueshme me qëllim përmirësimin e mësimdhënies siç janë pyetësorët e studentëve për stafin, pyetësorët e vetë stafit për institucionin etj.
<b>Kriteri 4</b>	Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.	Nga takimi që u bë në zyrën e burimeve njerëzore vihet re se të dhënat për rekrutimin e personelit akademik si me kohë të plotë ashtu edhe me atë të pjesshëm ruhen në vende të sigurta. Po ashtu aty ruhen edhe njoftimet për vendet vakante.
<b>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;	Përgjegjësi i Departamentit i cili është njëkohësisht edhe kordinatori i programit të masterit mban titullin Dr. (Phd) të marr në një universitet jashtë Shqipërisë dhe ka eksperiencë të gjatë akademike.
<b>Kriteri 2</b>	Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;	Nga vëzhgimet e bëra dhe nga takimet me studentët u pa se titullari i çdo lënde në

<b>Kriteri 3</b>		Masterën e Shkencave Gjuhë dhe Letërsi Turke ka të paktën gradën shkencore “Doktor”.
<b>Kriteri 4</b>	Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvujtë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;	Nga vëzhgimet e bëra dhe nga takimet me studentët u pa se titullari i çdo lënde në Masterën e Shkencave Gjuhë dhe Letërsi Turke ka të paktën gradën shkencore “Doktor”.
<b>Kriteri 5</b>	Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;	Nga takimet e bëra u pa se Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve.
	Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.	Departamenti ka personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale

**Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.**

<b>Kriteri 1</b>	Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;	Studentët që ndjekin programin Master I Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Turke kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;
<b>Kriteri 2</b>	Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;	Udhëheqësi është të paktën me gradën shkencore “Doktor”
<b>Kriteri 3</b>	Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.	Sipas rregullores së studimeve të ciklit të dytë udhëheqësi nuk mund të udhëheqë më shumë se 10 (dhjetë) studentë në një vit. Duke qenë se janë tema të ofruara në fushën e filologjisë dhe edukimit

**Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.**

<b>Kriteri 1</b>	Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.	Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit Master I Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Turke
<b>Kriteri 2</b>	Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.	Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Turke
<b>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;	Sipas bisedimeve të bëra me studentët, personeli ndihmës angazhohet në mënyrë rigoroze për mirëpërdorimin e ambienteve laboratorike dhe mjediset shkollore
<b>Kriteri 2</b>	Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Në përfundim të takimeve të bëra dallohet qartë që Institucioni përpiket të arrij përdorimin optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të ciklit të dytë.
<b>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;	Institucioni zbaton me rigorozitet Udhëzimin mbi ngarkesën mësimore të stafit akademik dhe marrëveshjet e punës që ka firmosur. Në rastet e paparashikuara në marrëveshje, Shefi i Departamentit bën 10 orë në javë, Prof.Dr. 12 orë në javë, Prof.As.Dr. 14 orë në javë, Dr. 16 orë në javë, Lektor 18 orë në javë, instruktori 20 orë në javë. Kjo ngarkesë mësimore është bërë duke u pasur parasysh angazhimi administrativ dhe kërkimi shkencor i stafit akademik.
<b>Kriteri 2</b>	Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.	Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.
<b>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b>		



<b>Kriteri 1</b>	Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;	Pas verifikimeve të bëra në zyrën e burimeve njerëzore u pa se të dhënat dhe dokumentat e nevojshme për personelin akademik qoftë atë efektiv, ashtu edhe atë me kontratë ruhen dhe arkivohen në mënyrë të sigurt. Dokumentacioni është sipas kërkesave të Zyrës së Punës dhe kërkesave të institucionit. Në dokumentacion përfshihet cv, të dhënat personale dhe punimet shkencore të personelit akademik.
<b>Kriteri 2</b>	Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;	Pas verifikimeve të bëra në dokumentacionin përkatës u pa se institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ
<b>Kriteri 3</b>	Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.	Pas studimit të dosjes me dokumentacionin e nevojshëm u vu re se Institucioni në kriteret e shpallura ka parasysh sinkronimin me Ligjin e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë si dhe kriteret specifike për çdo rast. Një nga pikat ku insistohet është kërkesa për personel akademik me gradën shkencore “Doktor”
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b> Në përfundim të vlerësimit të përgjithshëm për kërkesat e mësipërme u arrit në përfundimin që institucioni i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara. Zyra e burimeve njerëzore duhet të bëjë kujdes që në dokumentacionin e personelit akademik me kontratë, përkrah dokumentacionit të dorëzuar, të gjenden edhe fotokopjet e punimeve shkencore (artikuj, kumtesa) të deklaruar se ata kanë zhvilluar në cv e dorëzuar.</p>		

#### 4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

##### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
<b>Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;	Institucioni për momentin ndodhet në një ambient me qera, me një kontratë afatgjatë deri në përfundimin e kompleksit universitar të nisur dhe që pritet të mbarojë në vitin 2015.
<b>Kriteri 2</b>	Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;	Institucioni ndodhet në këtë ndërtesë që prej hapjes së tij në vitin 2011.
<b>Kriteri 3</b>	Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një	Programi i studimit ofrohet

<p><b>Kriteri 4</b></p>	<p>godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>në të njëjtën ndërtesë duke plotësuar kushtet e nevojshme për zhvillimin me standarte dhe efikasitet të programit.</p> <p>Institucioni nuk ofron programe studimi të tilla.</p>
<p><b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b></p>		
<p><b>Kriteri 1</b></p>	<p>Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p>	<p>Pas bisedës me punonjësit e bibliotekës dhe vlerësimit të bibliografisë në lidhje me këtë program u pa se në bibliotekë ka literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore.</p>
<p><b>Kriteri 2</b></p>	<p>Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p>	<p>Në bibliotekë ka një larmi librash të nevojshëm për zhvillimin e programit Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Turke duke plotësuar nevojat për bibliografi për kërkimin shkencor dhe përgatitjen e tezës.</p>
<p><b>Kriteri 3</b></p>	<p>Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p>	<p>Ndonëse një bibliotekë relativisht e re në të gjenden një shumëllojshmëri me botime periodike dhe është e regjistruar në bibliotekën online Jstore.</p>
<p><b>Kriteri 4</b></p>	<p>Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p>	<p>Pas bisedimeve me përgjegjësit e bibliotekës dhe përgjegjësit e programit u pa se ata kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p>
<p><b>Kriteri 5</b></p>	<p>Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Biblioteka është e hapur në orarin 8:00-17:00 nga e hëna në të shtunë. Do të ishte e këshillueshme të krijohej mundësia që biblioteka të qëndronte e hapur edhe pasditeve për një shfrytëzim më të plotë të saj.</p>
<p><b>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</b></p>		

<b>Kriteri 1</b>	Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;	Institucioni në tërësinë e tij ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra dhe mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;
<b>Kriteri 2</b>	Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;	Pas vizita e ambienteve të institucionit u pa se pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie dhe të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike në përputhje me qëllimet e programit.
<b>Kriteri 3</b>	Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;	Në laboratorin e Gjuhëve të Huaja janë të gjitha kushtet e nevojshme. Institucioni për shkak të roflit të tij filologjik nuk ka laboratorë të tjerë.
<b>Kriteri 4</b>	Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.	Institucioni ka vetëm një laborator. Atë të Gjuhëve të huaja të pajisur me gjithë infrastrukturën e nevojshme.
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b> Pas të vlerësimit në total të infrastrukturës u arrit në përfundimin se Institucioni i plotëson të gjitha kushtet e nevojshme për të zhvilluar programin Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Turke.		

## 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

### Vlerësimi sipas Standardeve

<b>Standardi/Kriteret</b>		<b>Vlerësimi për Kriteret dhe standardet</b>
<b>Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Duke qenë se institucioni është i ri nuk ka ende një raport të tillë.
<b>Kriteri 2</b>	Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Nuk ka ende një raport të tij pasi sipas procedurave ai do të kryhet në pjesën e parë të vitit 20113
<b>Kriteri 3</b>	Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.	Nuk ka ende një raport.
<b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>		

<b>Kriteri 1</b>	Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.;	Nuk ka ende nje raport të tillë pasi do të hartohet brenda tre mujorit të parë të vitit 2013.
<b>Kriteri 2</b>	Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.	Duke qenë një institucion jofitimprurës ai është i bazuar në sponsorizimet.
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b> Duke qenë se nuk ka një raport, nuk mund të japim një vlerësim të kësaj pjese.		

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

	Anëtarët e NJSBC	Detyra që ka në NJSBC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1	Dr. Bayram Karci	Kryetar	27.02.2012
2	Ramadan Çipuri	Zv. Kryetar	27.02.2012
3	Prof. As. Dr. Rahim Onbashi	Anëtar	27.02.2012
4	Manjola Çollaku	Anëtar	27.02.2012
5	Arti Omeri	Anëtar	27.02.2012
6	Albi Koçibelli	Anëtar	27.02.2012
7	Nertil Bërdufi	Anëtar	27.02.2012
8	Enriketa Soçtlü	Anëtar	27.02.2012
9	Gentjan Skara	Anëtar	27.02.2012

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
<b>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë duke u bazuar kryesisht në ecurinë e e studentëve dhe në përmirësimin e mësimdhënies.
<b>Kriteri 2</b>	Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	Pas takimeve me përfaqësuesit e institucionit u pa se Institucioni vazhdon të hartojë politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë
<b>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b>		

<p><b>Kriteri 1</b></p> <p><b>Kriteri 2</b></p> <p><b>Kriteri 3</b></p> <p><b>Kriteri 4</b></p> <p><b>Kriteri 5</b></p>	<p>Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p>	<p>Vlerësimi është në proces e sipër.</p> <p>Për vlerësimin akademik Institucioni ka ngritur Bordin e Vlerësimit Akademik dhe të Zhvillimit të Cilësisë/ Duke u bazuar në kompetencat që ka për rritjen dhe ruajtjen e cilësisë ai përdor Sondazhet me:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Studentët</li> <li>b. Sondazh për vlerësimin e mësimdhënies, kurrikulës, të mësuarit.</li> <li>c. Pyetje konceptuale</li> <li>d. Dëgjime në auditor</li> <li>e. Vlerësimin e rezultateve të arritura nga studentët</li> <li>f. Vlerësimine rezultateve të arritura në detyrat e kryera gjatë programit të studimit. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve.</li> </ol> <p>Në çdo fund semestri Bordi i Vlerësimit bën vlerësimin duke u bazuar në pikat e mësipërme dhe ja paraqet ato Rektoratit dhe pedagogëve me zarf të mbyllur.</p> <p>Në Shkollën e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) është Senati organi kolegjal i cili merret me përcaktimin e politikave të zhvillimit të institucionit duke bashkërenduar dhe kontrolluar veprimtaritë mësimdhënëse. Senati në bashkëpunim me zyrën e menaxhimit të kurrikulave bën përmirësimin e programeve kur është e nevojshme.</p> <p>Pas takimeve dhe vlerësimit të bërë u vu re se institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe nevojës për sigurimin e cilësisë në to. Për këtë arsye ata kanë vënë në dispozicion të studentëve dhe stafit Guidën Studentore dhe Guidën e Stafit, ku shprehet qartë rëndësia e cilësisë dhe sigurimi i saj në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Po ashtu me qëllim</p>
---	---	--

<p><b>Kriteri 6</b></p>	<p>Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>rritjen e ndërgjegjësimit është bërë edhe konferenca e parë ndërkombëtare e titulluar “Sfidat dhe zhvillimi i cilësisë në arsimin e lartë”</p> <p>Institucioni ka ahrtuar dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politikat dhe procedurat janë te publikuara në planin strategjik.</p>
<p><b>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</b></p>		
<p><b>Kriteri 1</b></p>	<p>Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p>	<p>Këshili i vlerësimit Akademik vlerëson periodikisht frytshmërinë e veprimtarisë mësimore, kërkimit shkencor dhe administrimit të shkollës. Këshili ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit dhe publikon rezultatet e vlerësimit të kryer.</p>
<p><b>Kriteri 2</b></p>	<p>Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p>	<p>Raporti përfshihet në raportin për vetëvlerësim institucional.</p>
<p><b>Kriteri 3</b></p>	<p>Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit publikohen.</p>
<p><b>Kriteri 4</b></p>	<p>Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.  <u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</li> <li>Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</li> <li>Pyetje konceptuale;</li> <li>Intervista;</li> <li>Etj.</li> </ol> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare /ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</li> <li>Dëgjime në auditor;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);</li> <li>Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> <li>Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</li> <li>Etj.</li> </ol>	<p>Institucioni përfshin studentët në vlerësimin e pedagogëve dhe zbatimin e programeve të studimeve. Në fund të çdo semestri, përpara sezonit të provimeve nëpërmjet anketimeve të përgatitura studentët japin mendimin e tyre në lidhje me pedagogun dhe brendësinë e lëndës. Në anketim ka seksione të lidhura me:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Pyetje lidhur me përmbajtjen e lëndës.</li> <li>Pyetje mbi performancën e pedagogut të lëndës.</li> <li>Pyetje mbi shërbimin e ofruar nga institucioni.</li> <li>Pyetje konceptuale</li> <li>Rekomnadime nga studentët.</li> </ol> <p>Metodat e drejtpërdrejta përfshihen edhe në sylabuset e lëndës si:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Vlerësimi me pikë për aktivizimin në auditor.</li> <li>Vlerësime me notë edhe pikë.</li> <li>Vlerësim të detyrave të kryera nga studentët</li> <li>Vlerësim për përfshirjen në aktivitete jashtë</li> </ol>

		shkollore. Programet e studimeve përmirësohen duke marr për bazë për bazë rezultatet e vlerësimit të tyre nga personeli akademik dhe nga studentët. Pas çdo rezultati të siguruar nga anketimi me studentë në bazë departamenti, bëhet rivlerësimi i brendësisë së lëndës, i cili dërgohet për miratim në këshillin e fakultetit, për t'u miratuar më pas nga senati. Një tjetër anketim zhvillohet me anëtarët e stafit akademik dhe administrativë, të cilët në mënyrë periodike japin opinionet në idhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe administrativ brenda institucionit.
<b>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;	Për momentin institucioni është në pjesën e përgatitjes së raportit për vlerësimin e brendshëm.
<b>Kriteri 2</b>	Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj., për vlerësimin e brendshëm.	Për momentin nuk ka.
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u> Vlerësimi i brendshëm i institucionit funksionon në mënyrë të rregullt duke bërë të mundur përmirësimin e cilësisë dhe përshtatjen e programeve me kërkesat dhe pritshmërinë e studentëve. Programi i plotëson kriteret e kërkuara.		

## **POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE**

### **7. Programi i studimit, organizimi i tij**

#### **Pjesa përshkrimore**

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Turke në shkollën e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) është pjesë e përbërëse e Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit. Departamenti i Gjuhës dhe letërsisë turke vepron si njësi bazë mësimore dhe kërkimore duke u bazuar tek “Ligji i arsimit të lartë” në republikën e Shqipërisë dhe përfshin fusha kërkimi në disiplinën e gjuhës dhe letërsisë turke. Në këtë kuadër departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtarinë kërkimore duke mbështetur lirinë akademike të personelit.

Departamenti u jep mundësi arsimimi të gjithë të interesuarve që kërkojnë të bëjnë karrierën e tyre profesionale si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat si në fushën akademike ashtu edhe në fushën e mësuesisë në gjuhën Turke.

Programi i Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Turke është projektuar që t'u ofrojë studentëve një formim intelektual duke ofruar një shumëllojshmëri konceptuale dhe prespektivë në fushën e gjuhësisë dhe letërsisë, si dhe fusha të ngjashme me to.

#### **Tregues të matshëm:**

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi
- Organizimi i çdo programi studimi (vite, semestra, javë etj.)
  - 1 vit akademik ka \_\_\_\_\_ javë mësimore në auditor
  - 1 Semestër ka \_\_\_\_\_ javë mësimore në auditor

- Në Planet mësimore të jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë
- Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Tabela 5)

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet \_\_\_\_\_ orë në auditor dhe \_\_\_\_\_ orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret \_\_\_\_\_ orë në auditor dhe \_\_\_\_\_ orë punë e pavarur e studentit
- Për Laboratoret \_\_\_\_\_ orë në auditor dhe \_\_\_\_\_ orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikat lëndore \_\_\_\_\_ orë në auditor dhe \_\_\_\_\_ orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale \_\_\_\_\_ orë në auditor dhe \_\_\_\_\_ orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar \_\_\_\_\_ orë në auditor dhe \_\_\_\_\_ orë punë e pavarur e studentit

- Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabela 6)

Lënda /Moduli		Pedagogu/Pe dagogët përgjegjës	Titulli /grada kualifikimi	Departamenti	Statusi PAE apo PAK
1.	Teknikat dhe metodat e kërkimit shkencor	Adem Balaban	Dr.	Gjuhë dhe letërsi	PAE
2.	Shqyrtimi i gjuhës turke	Ceyhun Vedat Uygur	Prof. Dr.	Gjuhë dhe letërsi	PAE
3.	Shkenca gjuhësore (Gjuhësi)	Adriatik Derjaj	Dr.	Gjuhë dhe letërsi	PAK
4	Burimet klasike të letërsisë turke	Bünyamin Çağlayan	Dr.	Gjuhë dhe letërsi	PAE
5	Mënyrat dhe llojet letrare	Sezayi Coşkun	Prof. As. Dr.	Gjuhë dhe letërsi	PAE
6	Burimi i veprave të turqishtes së mesme	Adem Balaban	Dr.	Gjuhë dhe letërsi	PAE
7	Gramatika e Turqishtes klasike Osmane	Bünyamin Çağlayan	Dr.	Gjuhë dhe letërsi	PAE
8	Transfërimi i veprave të vjetra në gjuhën aktuale	Cihan Okuyucu	Prof. Dr.	Gjuhë dhe letërsi	PAE
9	Burimet e reja të letërsisë turke	Cihan Okuyucu	Prof. Dr.	Gjuhë dhe letërsi	PAE
10	Kërkimet e letërsisë popullore	Sezayi Coşkun	Prof. As. Dr.	Gjuhë dhe letërsi	PAE
11	Kërkimet Historike të gjuhës Turke	Ceyhun Vedat Uygur	Prof. Dr.	Gjuhë dhe letërsi	PAE
12	Ushtrime në mësimdhënien e gjuhës së huaj dhe aftësitë gjuhësore.	Bünyamin Çağlayan	Dr.	Gjuhë dhe letërsi	PAE
13	Seminar	Adem Balaban	Dr.	Gjuhë dhe letërsi	PAE
14	Metoda të mësimdhënies së gjuhës së huaj	Bünyamin Çağlayan	Dr.	Gjuhë dhe letërsi	PAE
	Tezë				

- Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë



- Temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Dokumentacioni përkatës, i marrë në institucion

### Vlerësimi sipas Standardeve

<b>Standardi/Kriteret</b>		<b>Vlerësimi për Kriteret/ standartet</b>
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Institucioni ofron programe të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Institucioni është në process akreditimi.
<b>Kriteri 2</b>	Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>		
<b>Kriteri 2</b>	Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;	Programi i studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në Gjuhë dhe Letërsi Turke i pajis studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë professional.
<b>Kriteri 3</b>	Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;	Programi i studimeve “Master i Shkencave” në Gjuhë dhe Letërsi Turke synon të zgjerojë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve.
<b>Kriteri 4</b>	Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;	Shkolla e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) nuk ofron programe masteri në fushat e mjekësisë, stomatologjisë, farmacisë, veterinarisë dhe arkitekturës.
<b>Kriteri 5</b>	Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që	Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët

	<p>synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>
<b>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b>		
	<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>
<b>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</b>		
	<p><b>Kriteri 1</b> Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Pas vlerësimit të dokumentave u vu re se përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Pas vlerësimit të dokumentave përkatës dhe intervistave me studentë u vu re se metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>
<b>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</b>		

<b>Kriteri 1</b>	Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane;	Në përgatitjen e programeve të studimeve hartuesit kanë analizuar dhe studiuar kurrikulat e universiteteve me përvojë të gjatë në këtë fushë duke u përpjekur t'i përshtasin me kushtet e tregut të punës në Shqipëri.
<b>Kriteri 2</b>	Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;	Pas studimit të dokumentacionit përkatës u vu re se programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;
<b>Kriteri 3</b>	Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.	Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara
<b>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;	Pas vlerësimit të dokumentacionit përkatës dhe intervistave me studentët dhe dallohet qartë se programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;
<b>Kriteri 2</b>	Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;	Programet e studimit për Master i Shkencave Gjuhë dhe Letërsi Turke janë hartuar në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;
<b>Kriteri 3</b>	Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizmin e programeve të studimeve;	Pas bisedimeve me drejtuesit dhe Personelin akademik u pa se institucioni nxit dhe mbështet edhe financiarisht angazhimin në punën kërkimore shkencore për realizmin e programeve të studimeve të personelit akademik.

<b>Kriteri 4</b>	Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.	Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.
<b>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;
<b>Kriteri 2</b>	Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.	Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.
<b>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;	Ndonëse nuk ka një studim të mirëfilltë bazuar në programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;
<b>Kriteri 2</b>	Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin: <ul style="list-style-type: none"> <li>a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar;</li> <li>b. kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ul>	Institucioni ka bërë një studim për nevojat e tregut në lidhje me gjithë programet që ofron.
<b>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;	Programi i studimeve “Master i Shkencave” në gjuhë dhe letërsi turke realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre
<b>Kriteri 2</b>	Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.	Programi i studimeve “Master Profesional” realizohet me 90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.
<b>Kriteri 3</b>	Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).	Institucioni nuk ofron programe të integruara të ciklit të dytë.

<b>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;	Mënyra e diplomimit shprehet në rregulloren e programit të studim për master.
<b>Kriteri 2</b>	Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.	Për realizimin e programit të studimeve “Master i Shkencave” është parashikuar 30 kredite për projektin kërkimor dhe tezën
<b>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;	Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët; Lektorit në orën e pare të fillimit të lëndës bën prezantimin e syllabusit
<b>Kriteri 2</b>	Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u> Pas vlerësimit të dokumentacionit përkatës si dhe takimeve me personelin akademik dhe studentët u pa se programi i përmbush kriteret e kërkuar. Duhet të kihet më kujdes në terminologjinë e përdorur në emërtimin e lëndëve.		

## 8. Mësimdhënia

	<b>Programi i Studimit Master i Shkencave në gjuhë turke dhe letërsi turke</b>	
	Format e Mësimdhënies	Orët totale në auditor
a.	Leksione	320
b.	Seminare	240
c.	Ushtrime	
d.	Laburatore	
e.	Praktikë Lëndore	
f.	Praktikë Profesionale	
g.	Etj	
	Në total	580

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

### **Tregues të matshëm:**

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:
  - Leksione
  - Seminare
  - Ushtrime
  - Laboratore
  - Praktikë lëndore
  - Praktikë profesionale
  - Etj
- Format e kontrollit të njohurive
- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësive etj

## **9. Studentët**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

### **Tregues të matshëm:**

- Procedurat e pranimit të studentëve
- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve
- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë)
- Nota Mesatare
- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse)
- Nota Mesatare
- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend
- Të dhëna për punësimin e studentëve
- Numri total të diplomuarve
- Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)
- Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)
- etj

### **Vlerësimi sipas Standardeve**

<b>Standardi/Kriteret</b>	<b>Vlerësimi për Kriteret dhe standardet</b>
<b>Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	

<b>Kriteri 1</b>	Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;	Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;
<b>Kriteri 2</b>	Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;	Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;
<b>Kriteri 3</b>	Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;	Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;
<b>Kriteri 4</b>	Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;	Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;
<b>Kriteri 5</b>	Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.	Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.
<b>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;	Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;
<b>Kriteri 2</b>	Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;	Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;
<b>Kriteri 3</b>	Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.	Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.
<b>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>		



<b>Kriteri 1</b>	Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;	Institucioni nuk ka ende të diplomuar.
<b>Kriteri 2</b>	Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;	Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;
<b>Kriteri 3</b>	Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.	Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.
<b>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikën e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;	Institucioni nuk ka akoma të diplomuar.
<b>Kriteri 2</b>	Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.	Institucioni nuk ka akoma të diplomuar.
<b>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;	Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;
<b>Kriteri 2</b>	Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;	Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;
<b>Kriteri 3</b>	Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.	Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.
<b>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;	Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;
<b>Kriteri 2</b>	Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.	Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b> Pas vlerësimit të dokumentacionit përkatës si dhe takimeve me personelin akademik dhe studentët u pa se programi i përmbush kriteret e kërkuar.		



## KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

### 10. Kërkimi shkencor

#### Pjesa përshkimore

**Terma reference:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

#### Tregues të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor
- Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL
- Numri i projekteve kërkimore të fituara
- Numri i projekteve të zbatuara
- Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL
- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda iAL
- Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor
- Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor
- Numri i Çmimeve Kombëtare
- Dokumentacioni përkatës i marrë gjatë vizitave

#### Vlerësimi sipas Standardeve

<b>Standardi/Kriteret</b>		<b>Vlerësimi për Kriteret dhe standardet</b>
<b>Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disipinën përkatëse;	Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disipinën përkatëse;
<b>Kriteri 2</b>	Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.
<b>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;	Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;
<b>Kriteri 2</b>	Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në	Personeli akademik që angazhohet në

	atë gjuhë, prej së paku një semestri.	mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.
<b>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;	Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;
<b>Kriteri 2</b>	Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.	Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit
<b>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;	Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;
<b>Kriteri 2</b>	Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;	Në shumicën e rasteve Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;
<b>Kriteri 3</b>	Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.	Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b> Pas vlerësimit të dokumentacionit përkatës si dhe takimeve me personelin akademik dhe studentët u pa se programi i përmbush kriteret e kërkuar. Institucioni duhet të kërkojë të ketë në dispozicion të tijin të gjithë punimet, artikujt apo librat e botuar nga personeli akademik që jep mësim në programin Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Turke</p>		

## 11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

### **Tregues të matshëm:**

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar
  - Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare
  - Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj
  - Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit
  - Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL
  - Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor
  - Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime
  
- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:
  - Institucionet qeveritare bashkëpunuese
  - Organizatat Profesionale
  - Komuniteti i biznesit, tregu i punës
  
- Dokumentacioni përkatësi marrë nga vizita në institucion

### **Vlerësimi sipas Standardeve**

<b>Standardi/Kriteret</b>		<b>Vlerësimi për Kriteret dhe standardet</b>
<b>Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.</b>		
<b>Kriteri 1</b>	Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;	Institucioni i kushton një rëndësi të veçantë kryerjes së praktikës për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”. Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të shumta arsimore që do të bëjnë të mundur kryerjen e praktikës.
<b>Kriteri 2</b>	Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.	Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave”. Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të shumta arsimore dhe me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që do të bëjnë të mundur kryerjen e praktikës.
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b> Institucioni ka marrëdhënie shumë të mira bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm si brenda edhe jashtë vendit të cilat bëjnë të mundur kryerjen e praktikave të studentëve.		

## **ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

RVJ mbyllet me “**Analizën përmbledhëse të RVJ**” sipas metodës **SWOT** (**S**trengths-pikat e forta, **W**eaknesses- pikat e dobëta, **O**pportunities-mundësitë, **T**hreats-pengesat).

### **a. Pika të forta:**

- 1) Programi është hartuar duke u bazuar në përvojën shumë vjeçare të universiteteve me përvojë në këtë fushë.
- 2) Personeli akademik është i përgatitur dhe me eksperiencë të gjatë në mësimdhënie. Fakti i të qenurit në shumicë personel turk (i huaj) është një avantazh i madh për programin.
- 3) Bashkëpunim me shumë universitete të huaja.
- 4) Mësimi i dy gjuhëve të huaja. (përveç shqipes)
- 5) Numri i kufizuar i studentëve në klasë.
- 6) Infrastrukturë moderne
- 7) Biblotekë me shumëllojshmëri të madhe librash.

### **b. Pika të dobëta:**

- 1) Personel akademik i brëndshëm ende në numër të pamjaftueshëm. (mungesa e asistentëve).
- 2) Pamundësia për të bërë anketime në bazë shkencore.
- 3) Mos pasja e shumë studentëve shqiptarë
- 4) Mesatarja jo shumë e lartë e aplikantëve.

### **c. Mundësitë:**

- 1) Mundësi financimi projektesh nga brenda dhe jashtë vendit.
- 2) Bashkëpunimi me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

### **d. Pengesat:**

- 1) Gjetja e financimeve në kohë për projekte të ndryshme.
- 2) Numri i madh i Shkollave të Larta Jopublike.

### **Grupi i Vlerësimit të Jashtëm**

**1. Prof. Dr. Ferit Duka**

**2. Dr. Alban Foçi**